

V E N D I M
Nr. 90, datë 21.3.2002

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
LEZHË-BALLDRE, PJESË E SEKSIONIT LEZHË-SHKODËR**

(Ndryshuar me VKM nr. 61, datë 28.1.2005)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Lezhë-Balldre, pjesë e seksionit Lezhë-Shkodër.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe 24 828 m² tokë/arë, 3592 m² truall, 521 m² objekte, 1 pikë karburanti, 24838 m² kulturë bujqësore (jonxhë), 956 copë dru frutorë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 59 718 112 (pesëdhjetë e nëntë milionë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekësh.

3/1. Pronarët e pasurive të paluajtshme shtesë, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqe 3453 m² tokë arë, për një objekt, me vlerë 6 896 515 (gjashtë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë, dru frutorë me vlerë 250 500 (dyqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, kultura bujqësore me vlerë 41 436 (dyzet e një mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, me një vlerë të përgjithshme prej 10 341 040 (dhjetë milionë e treqind e dyzet e një mijë e dyzet) lekësh.

4. Vlera e shpenimeve procedurale të jetë në shumën prej 441 000 (katërqind e dyzet e një mijë) lekësh.

4/1. Vlera e shpenzimeve procedurale për këtë shtesë shpronësimi është në shumën 294 000 (dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë.

5. Fondi prej 60 159 112 (gjashtëdhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekësh për kompensimin e pronarëve të shpronësuar dhe shpenzime procedurale, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, të përballohet nga Buxheti i Shtetit i vitit 2002, në zërin "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

5/1. Vlera e përgjithshme e shpronësimit për pasuritë shtesë prej 10 635 040 (dhjetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë mijë e dyzet) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2005, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.5.2002.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Shih tabelat A1, A2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA JURIDIKE
QARKU LEZHË

Lista e pronarëve që shpronësohen (shtesë e projektit) për shkak të ndërtimit të segmentit rrugor Lezhë-Balldre (seksioni i I-rë)

(Shtuar me VKM nr. 61, datë 28.1.2005)

Lloji i pasurisë: Tokë arë, kulturë bujqësore, dru frutorë dhe objekt nr.8

Nr.	Pronar			Nr. Pas.	Tokë arë			Objekt			Kul. Buj. 12 lekë
	Emri	Atësia	Mbiemri		Sip. m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera në lekë	Sip. m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera në lekë	
1	Kole	Mark	Guri	13/61,13/68					preventiv	6896515	
2	Gjok	Dedë	Nika	349/12	511	913	466543				613
3	Zef	Pashko	Nika	350/10	382	913	348766				458
4	Zef	Pashko	Nika	349/15	750	913	684750				900
5	Luk	Pashko	Nika	350/11	662	913	604406				794
6	Ndok	Fran	Gjoni	349/12	388	913	354244				465
7	Mikel	Ndok	Gjoni	349/11	114	913	104082				136
8	Luk	Rrok	Dedgjoni	447/4	646	913	589798				775
	Shuma				3453		3152589			6896515	414

Shpenzime procedurale lekë 294 000

Vlera totale e shpronësimit lekë 10 635 040